




RAPORT PËRMBLEDHËS i dëgjimeve buxhetore për vitin 2023

Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2018, neni 6 pika 1.2 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe bazuar në Statutin e Komunës së Deçanit, Kuvendi Komunal dhe Drejtoria për Buxhet, kanë mbajtur takime publike me qytetarë dhe grupe të interesit, për ta diskutuar Draft buxhetin për vitin 2023. Këtyre dëgjimeve iu kishin paraprirë edhe dëgjimet e organizuara në maj dhe qershor, ku ishte diskutuar Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB).


Dëgjimet buxhetore të udhëhequra nga kryesuesi i Kuvendi, Hajdar Sutaj dhe drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet, Dafina Cacaj, kanë filluar në javën e parë të muajt shtator. Për dallim nga dëgjimet buxhetore të KAB-it (ishin mbajtur 4 dëgjime), tashmë janë mbajtur 7 dëgjime buxhetore. Me iniciativë të "Shoqatës së Intelektualëve të Pavarur" si partnere e KDI-së, është mbajtur dëgjim buxhetor edhe me krijuesit letrar, sportistët individual, artistët e skenës, muzikantët, etj.

Dëgjimi për grantin e arsimit nuk është mbajtur ngase kanë munguar përfaqësuesit e shkollave me arsyetimin se janë në grevë. Dëgjimet buxhetore, përpos grantit të shëndetësisë dhe arsimit, janë mbajtur edhe me përfaqësuesit e Këshillave të fshatrave, të OJQ-ve, grupeve joformale të grave, krijues letrar... dhe qytetarë pa dallim.

Grafikoni 1: Pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjimet publike



Në 7 (shtatë) dëgjimet buxhetore kanë marrë pjesë 110 meshkuj dhe 52 femra. Kërkesat e të pranishmëve ishin varësisht nga lloji i dëgjimit. Në takimin me përfaqësuesit e fshatrave dhe takimin me qytetarë, kërkesat kryesisht ishin infrastrukturore (rrugë, ujësjellës, kanalizim, trotuare, pengesa rrugore, etj). Në takimet e mbajtura me grupet e veçanta të interesit, kryesisht është kërkuar buxhet për realizimin e projekteve grupore apo individuale. Pothuajse në të gjitha dëgjimet buxhetore ishin të pranishëm edhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa. Mirëpo, në disa takime kishin ardhur edhe anëtar të Kuvendit komunal që ishin të interesuar për t'i dëgjuar kërkesat e qytetarëve dhe grupeve të interesit.




Buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2023:

- Paga dhe medijtje- 5,800,000.00 €
- Investime kapitale- 3,819,805.00 € për investime kapitale
- Subvencione dhe transfere – 200,000.00 €
- Shpenzime komunale – 200,000.00 €
- Mallra dhe shërbime – 2,100,000.00 €

Gjithsej: 12,119,805.00 € (dymbëdhjetë milion e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesë euro)

Grafikoni 3: Ndarja buxhetore



Deçan,
21.09.2022

Përgatitur nga
Dyke Llojuni